

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN ÇËRRAVË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Çërravë, Pogradec**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 30, datë 26.03.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1206/9, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Reshit Fraholli, Kryetar i komunës Çërravë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Gjetje nga auditimi

Nuk ka ndarje të detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut V, pika 1, germa “a”

1.2. Rekomandimi

Detyrat e Njesisë së Prokurimit të përcaktohen nga titullari i Komunës Çërravë, sipas kërkesave të nenit 57 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”.

Në vijimësi

2.1. Gjetje nga auditimi

Në procedurat e prokurimit, në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave janë caktuar, punonjës në kundërshtim me kërkesat e germës “ç”, pika 2 Kreu V i VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është caktuar z. I.E, me detyrë nënkryetar dhe përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe anëtare znj. E.H, drejtores e Drejtorisë së Financës, të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e preventivave dhe të specifikimeve teknike të tenderave të zhvilluar, që janë pjesë të dokumenteve të tenderit.

2.2. Rekomandimi

Në drejtimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të caktohen punonjës të nivelit drejtues, si dhe në komision të mos marrin pjesë punonjës që kanë punuar për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, kjo në zbatim të nenit 58 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Në vijimësi

3.1. Gjetje nga auditimi

Për iniciimin e kryerjes të blerjeve të karburantit dhe të druve të zjarrit ishte bërë një kërkesë drejtuar Kryetarit të Komunës, nga z. I.Ei, përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe znj. E.H, përgjegjëse e Zyrës së Financës. Me urdhrat përkatës Kryetari i Komunës ka ngritur grupin e punës me 3 punonjës për caktimin e fondit limit, dhe në çdo rast ka mbajtur vetëm një procesverbal ku miratohej fondi limit në vlerë monetare, pa hartuar preventiv për të përcaktuar sasinë e mallit që nevojitej për tu blerë.

Në dosjet e tenderit nuk ka asnjë dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, apo sasinë e druve të zjarrit të nevojshme për institucionet shkollore dhe komunën.

Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç”.

3.2. Rekomandimi

Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen dhe të përcaktohen hollësisht specifikimet teknike, në zbatim të nenit 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

4.1. Gjetje nga auditimi

Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

- Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.
- Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listëpagesat e sigurimeve shoqërore.
- Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit.
- Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.
- Specifikimet teknike janë të përgjithshme.
- Liçensë profesionale për tregtimin e karburantit;
- Çertifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë .

4.2. Rekomandimi

Nga Njësia e Prokurimit në çdo rast në dokumentet e tenderit duhet të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

5.1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezulton se nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, i cili duhej të përshkruante ecurinë e procesit të prokurimit publik të zhvilluar, kërkesa këto të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”. Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO-së dhe ata të Njesisë së Prokurimit .

5.2. Rekomandimi

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në çdo rast, duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, duhet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimi, në zbatim të dispozitave të mësipërme”.

Në vijimësi

6.1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tendera rezultoi se në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues, si:

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje dru zjarri**”, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik, që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi
- Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Sistemim i qendrës së fshatit Çërravë**”, nga auditimi rezultoi se në formatin elektronik të dokumenteve kualifikuese të operatorit ekonomik Shoqëria “Kthella”sh.p.k. se mungon:
 - Deklarata e ofertuesit që të vërtetojë që nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1, të LPP, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.
 - Dokumenti që ofertuesi të vërtetojë disponimin e një nyje të prodhimit të betonit dhe të liçensës përkatëse për prodhim betoni, inerte dhe kontrata e blerjes, qirasë, apo zhdoganimi i impiantit të betonit.

6.2. Rekomandimi

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit duke u mbështetur në plotësimin e tyre me dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

7.1. Gjetje nga auditimi

Për zbatimin e kontratave të furnizimit me karburant për vitet 2013 dhe 2014 në asnjë rast nuk është ngritur komision për pritjen e mallit, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” pika 42 e 43.

Po kështu mosnëgritja e komisionit me urdhër të veçantë për marrjen në dorëzim të mallit, bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b.

Për sa më lart, mbajnë përgjegjësi titullarët e institucionit për mos nxjerrjen e urdhrat për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit, si dhe drejtorja e Drejtorisë së Financës znj. Elida Hajdini, si përgjegjëse në rolin e Nëpunësit Zbatues, për Komunën Çërravë, mbështetur në kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues” pika 54.

7.2. Rekomandimi

Në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, të ngihet një komision me urdhër të veçantë, me të paktën 3 specialistë të fushës, sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave .

Në vijimësi

8.1 Gjetje nga auditimi

Nuk janë hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit. Nuk janë ndjekur dhe nuk ka raportime të titullari i njësisë publike për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, për të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejton..

8.2 Rekomandimi

Të ngrihet e miratohet një sistem për komunikimin dhe përcjelljen e informacionit ndërmjet sektorëve dhe eprorëve si pjesë e llogaridhënies, bashkëpunimit dhe e kontrollit të brendshëm, duke vendosur një sistem efikas të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

9.1 Gjetje nga auditimi:

Konstatohet se për vitet 2013 dhe 2014, për 37 subjekte të pa regjistruara, nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, ku në pikën 1.

9.2 Rekomandimi:

Komuna, të marrë masa për regjistrimin e subjekteve dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për 37 subjektet që kanë ushtruar aktivitet të pa regjistruar në QKR.

Brenda muajit Maj 2015

10.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i ushtruar për 62 subjekte, ose 95 për qind e tyre, rezultoi se janë hapur dosje individuale për secilin subjekt, por mungon inventari për përmbajtjen e materialeve në dosje dhe numri i fletëve. Dosjet nuk janë azhurnuar dhe përditësuar dhe të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, pasi në disa prej tyre mungon njoftim detyrimi, njoftim vlerësimi tatimor dhe dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), ndërsa në disa dosje mungojnë; deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gent planet, apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, etj.

Nuk është evidentuar dhe dokumentuar, lista e subjekteve që nuk kanë deklaruar në afat dhe nuk ka asnjë rast të gjobitur në masën 10.000 lekë, në kundërshtim me nenin 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”.

Për mos plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm dhe mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit Tatimor, në kundërshtim me nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, mbajnë përgjegjësi, z. Artan Besholli, me detyrë, ish Përgjegjës i Zyrës të Tatim Taksave, për periudhën e vitit 2013, deri më 25.3.2014 dhe z. Nertil Hoxha, me detyrë, Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave për periudhën e vitit 2014.

10.2 Rekomandimi:

Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në Komunën Çërravë të merren masa që për aktivitetin fiskal në vitin 2015, dosjet e subjekteve të plotësohen me dokumentet e kërkuara nga ligji.

Brenda muajit Maj 2015

11.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura nga Zyra e Tatim Taksave, rezulton se në Komunën Çërravë, nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), **37 subjekte**, që kryejnë aktivitete të ndryshme biznesi, të cilët ushtrojnë aktivitetin pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksë biznesi të vogël dhe tarifën vendore. Ndaj 37 subjekteve të paregjistruar në QKR, nga Zyra e Taksave të Komunës Çërravë, bazuar në nenet 11, 22 dhe 32 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi, dhe kanë llogaritur në planifikim të ardhura për buxhetet e viteve 2013 dhe 2014 për këto biznese të palicensuar, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë **për vlerën 122,610 lekë**.

11.2. Rekomandimi:

Zyra e Taksave Vendore në Komunë Çërravë, bazuar në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për 37 subjektet (sipas pasqyrës) të evidentuara si të palicensuara, të kryhen llogaritjet, për detyrimet e gjobat dhe të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Komunës, për vlerën gjithsej **122,610 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlere.

Brenda muajit Maj 2015

12.1. Gjetje nga auditimi

Për vitin 2013 rezultojnë debitore 1,118 familje për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 1,163 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 1,283 familje në vlerën 596 mijë lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 870 familje, për vlerën 435 mijë lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 1,201 familje në vlerën 720 mijë lekë.

Për vitin 2014 rezultojnë debitore 1,029 familje për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 1,027 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 1,028 familje në vlerën 477 mijë lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 662 familje, për vlerën 331 mijë lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 1,095 familje në vlerën 657 mijë lekë.

Gjithsej vlera debitore e subjekteve familjare arrin në shumën 5,406 mijë lekë, nga e cila 2,190 lekë për taksën e tokës, 1,073 mijë lekë për taksën e ndërtesës, 766 mijë lekë për taksën e pastrimit dhe 1,377 mijë lekë për taksën e ndriçimit.

12.2. Rekomandimi:

Nga ana e Zyrës së Taksave në Komunën Çërravë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore të pa likuiduara deri më datën 30.9.2013 për të 4 llojet e taksave të popullatës në vlerën 10,345 mijë lekë, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 5.945,000 lekë, taksa e banesave në vlerën 2,203,000 lekë, taksa e pastrimit në vlerën 1,475,000 lekë dhe taksë ndriçimi e gjelbërimi 722,000 lekë.

Brenda muajit maj 2015

13.1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se nga ana e Zyrës së Tatim Taksave të Komunës Çërravë nuk është arkëtuar **vlera prej 1,222,557 lekë**, që i përket tarifave vendore dhe taksës së biznesit të vogël për vitin 2013 në shumën 393,651 mijë lekë, vlerës së tarifave vendore dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2014 në shumën 580,186 lekë dhe detyrimeve për taksat e tarifave vendore të biznesit të madh për të dy vitet në shumën 248,720 lekë, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 114, pikën 1, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit”.

13.2. Rekomandimi

Nga ana e Zyrës së Taksave në Komunën Çërravë në bashkëpunim me Policinë e Komunës dhe Drejtorinë e Financës, të merren masa në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **1,222,557 lekë**, për subjektet debitorë të biznesit të vogël dhe të madh, (sipas pasqyrave përkatëse).

Brenda muajit Maj 2015

14.1. Gjetje nga auditimi :

Nga auditimi me zgjedhje, mbi zbatimin e procedurave ligjore për dhënien e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, rezultoi se nga 62 aplikues të rinj, u konstatua se 13 aplikues kanë përfituar me ndihmë ekonomike me dokumentacion jo të plotë, veprim ky në kundërshtim me gërmat “ç” e “d”, të pikës 2 të VKM nr. 787 datë 14.12.2005.

14.2.Rekomandimi :

Të ndërpritet trajtimi me ndihmë ekonomike ndaj familjeve të klasifikuara me mungesë dokumentacioni, sipas cilësimeve sa sipër.

Menjëherë

15.1.Gjetje nga auditimi :

Prej auditimit të ushtruar Komunës Çërravë rezultoi, se nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të Komunës Çërravë. Mungon e nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullor, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, neni 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullor”, neni 14, “Planë e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”. Gjithashtu theksojmë se për vitet 2013 dhe 2014 nuk janë krijuar të ardhura nga tarifat e përdorimit të kullotave dhe kositje, nga kapaciteti i kullotave në juridiksionin e kësaj Komune (llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”, sipas evidencës së inspektorit veteriner evidentohen 2250 krerë të imta x 100 lekë/krerë x 2 vjet = 450,000 lekë si njëhundrak 360,000 lekë për të dy vjetë janë arkëtuar 27,500 lekë diferencë 332,500 lekë, si konkluzion nga mos hartimi i planit përkatës të menaxhimit, mos parashikimit për dhënie me qira, mospërfshirja në buxhetet përkatës të secilit prej viteve si në pjesën e të ardhurave ashtu dhe në shpenzime, në rast realizimi do të sillnin zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave.

Rekomandimi :

15.2. Komuna Çërravë të marrë masat për hartimin e planit të menaxhimit e mbarështimi në pyje, kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

Brenda muajit Maj 2015

16.1. Gjetje nga auditimi :

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur lidhur me kryerjen e detyrës, nga ana e punonjësit të policisë në Komunën Çërravë, rezultoi se nuk ishte lidhur kontratë pune tre vjeçare, sipas përcaktimeve të pikës 9 të rregullores së Brendëshme “TIP”.

16.2. Rekomandimi:

Të lidhet kontrata e punës në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendëshme “TIP” si dhe për më tej, të bashkëpunohet me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë, për trainimin e punonjësve të policisë komunale.

Menjëherë

17.1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i dokumentacionit për kryerjen e pagesave me bankën, janë konstatuar shkelje të ligjshmërisë në llogaritjen, efektivitetin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit shoqërues të pagesave të kryera,

17.2. Rekomandimi:

Plotësimin rast pas rasti të dokumentacionit shoqërues të kryerjes së pagesave me bankën, në uniformitet me kriteret ligjore të parashikuara nga Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Në vijimësi.

18.1. Gjetje nga auditimi

Në një rast, është urdhëruar kryerja e pagesës për “Shërbim makine”, në shumën **49,800 lekë**, sipas U-Prokurimit nr. 7/1, datë 10.01.2013, për blerje me vlera të vogla.

Edhe në këtë praktikë të shlyerjes së veprimeve me bankën, nga auditimi i dokumentacionit

konstatohet se :

1. Fatura e thjeshtë tatimore të subjektit që ka kryer shërbimin, është e pa pajisura me vulën e biznesit.
2. Njëri nga zërat e punimeve të kryera e të faturuara, (*lavazho makine për periudhën Janar-Mars, në 76 rraste, për çimin 300 lekë*), gjithsej në vlerën 22,800 lekë, është e pa argumentuar me dokumentacionin përkatës të planifikimit të shërbimit si dhe jo në momentin e kryerjes së shërbimit.
3. Edhe zërat e tjera të shërbimit të faturuar, janë të pa argumentuara me kërkesën e planifikimit të shërbimit, si dhe të kryera nga një biznes i pa liçensuar për këtë lloj shërbimi. Edhe në këtë rast vepruar në kundërshtim me pikën 34, 35 dhe 36 të **UKM nr. 30** datë 27.12.2011, mbasi likujdimi i kësaj pagese, është kryer mbi bazën e një dokumentacioni të pa rregullt, i cili nuk përshkruan me vërtetësi dhe besueshmëri shkakun e veprimit .

18.2. Rekomandimi

Riorganizim të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla, njohjen në themel të legjislacionit si dhe zbatimin me rigorozitet të ligjshmërisë në kryerjen e pagesave.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi

Në një rast, është urdhëruar kryerja e pagesës në shumën **299,000 lekë**, për shërbimin e reabilitimit të kanalit ushqyes të një rezervuari, brenda juridiksionit të Komunës Çërravë.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues për kryerjen e pagesë sa sipër rezultojnë se:

1. Fatura e thjeshtë tatimore me nr.1 datë 14.01.2013, të subjektit të përzgjedhur, në procedurën e prokurimit “Blerje me Vlera të Vogla”, nuk është e shoqëruar me dokumentacionin për ushtrimin e këtij aktiviteti.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit Roveni Muçi, në Zyrën e Tatim Taksave në Komunën Çërravë, rezultojnë se ky subjekt, ka aktivitet tregtar për materjale ndërtimi dhe jo për sipërmarrje në ndërtim apo punime të tjera gërmimi e pastrimi.

Një praktikë e tillë bie në kundërshtim me referencë me nenin 29, pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, gjë që ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues, për autorizimin në likuidimin e pagesave.

19.1.Rekomandimi.

Riorganizim të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla, njohjen në themel të legjislacionit, zbatimin me rigorozitet të ligjshmërisë si dhe marrjen e masave ligjore për personat përgjegjës.

Menjëherë.

20. Gjetje nga auditimi

Në një rast, është urdhëruar kryerja e pagesës në shumën **399,425 lekë**, për shërbimin e “Pastrim i rrjetit kullues të kanaleve pritës të ujrave të larta”, brenda juridiksionit të Komunës Çërravë.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues për kryerjen e pagesë sa sipër rezultojnë se:

1. Fatura e thjeshtë tatimore me nr. 3 datë 18.01.2013, në shumën **286,227 lekë** dhe fatura nr. 4 datë 18.01.2013, në shumën **113,198 lekë**, të subjektit të përzgjedhur, janë të pa konfirmuara me vulën e biznesit.

2. Në procedurën e prokurimit “Blerje me Vlera të Vogla”, oferta e subjektit Ilir Muçi, nuk është e shoqëruar me dokumentacionin për ushtrimin e këtij aktiviteti.

3. Nga auditimi i dokumentacionit të subjektit Ilir Muçi, në Zyrën e Tatim Taksave në Komunën Çërravë, rezultojnë se ky subjekt, ka aktivitet tregtar për **“Tregtim artikuj të ndryshëm”** dhe jo për sipërmarrje në ndërtim apo punime të tjera gërmimi e pastrimi.

Një praktikë e tillë bie në kundërshtim me kondicionet ligjore parashikuar në nenin 29, pika 5 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, gjë që ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues të pagesës së shpenzimit të kryer, si dhe në reference me Kreu VI, pikën 2. “*Prokurim me vlerë të vogël*”, ngarkon me përgjegjësi komisionin e prokurimit sipas Kreut X, pika 3, për “Masat disiplinore” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar.

21.1. Rekomandimi

Komuna Çerrave të marrë masa që nga komisionit i prokurimit me Vlera të Vogla, të mos kryej blerje apo shërbime , pa u plotësuar dokumentacioni i nevojshëm ligjor dhe procedurat e caktuara.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Çërravë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 5,282,200 lekë, si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi:

- Të ardhurat nga qiraja e tokës për vitin 2013, sipas vendimit janë planifikuar në shumën 3,070 mijë lekë, bazuar në kontratat me subjektet qiramarrëse, kurse në fakt janë realizuar vetëm 694 mijë lekë, ose 22.6 përqind. Me mosrealizim është kontrata e lidhur me subjektin “A.... M”, ku vlera e qirasë është 300 mijë lekë dhe në fakt është realizuar 225 mijë lekë, me një diferencë prej 75 mijë lekë, si dhe kontrata me Shoqërinë “H...” sh.p.k. për qira toke në fond kullor në shumën 2,328,600 lekë, e cila nuk është realizuar. Gjithësej vlera e parealizuar nga kontratat e qirasë së tokës për vitin 2013 është 2,403 mijë lekë.

- Të ardhurat nga qiraja e tokës për vitin 2014, sipas vendimit janë planifikuar në shumën 3,070 mijë lekë, bazuar në kontratat me subjektet qiramarrëse, kurse në fakt janë realizuar vetëm 191 mijë lekë, ose 6.2 përqind, me një diferencë prej 2,878 mijë lekë, si rrjedhojë e mosrealizimit të kontratës me subjektin “A...” sh.a. për vlerën 150 mijë lekë, nga 300 mijë lekë që ishte kontrata është realizuar 150 mijë lekë, nga mos realizimi i kontratës me subjektin “V.....” për shumën 400 mijë lekë dhe mos realizimin e kontratës me subjektin Shoqëria “H.....” sh.p.k. në vlerën 2,328,600 lekë, për qira toke në fond kullor për vendosje aerogjeneratorësh. Gjithësej vlera e parealizuar nga kontratat e qirasë së tokës për vitin 2014 është 2,879 mijë lekë.

Për të dy vitet vlera e qirasë e pa arkëtuar arrin në 5,282,200 lekë.

1.2. Rekomandimi:

Të arkëtohet vlera 5,282,200 lekë, si qira e paarkëtuar në vitet 2013 – 2014 që i përket:

- Shuma 225,000 lekë, si qira e pa arkëtuar nga Shoqëria “A....” sh.a., nga e cila 75,000 lekë i takojnë vitit 2013 dhe 150,000 lekë i takojnë vitit 2014, për tokën e marrë me qira.

- Shuma 400,000 lekë, si qira e paarkëtuar në vitin 2014 nga Shoqëria “V....” sh.a., për tokën e marrë me qira.

- Shuma 4,657,200 lekë, si qira e paarkëtuar nga Shoqëria “H.....” sh.p.k., që i takon vlerës vjetore të qirasë prej 2,382,600 lekë për vitin 2013 dhe 2,382,600 lekë për vitin 2014, për fondin kullor të marrë me qira për vendosjen e aerogjeneratorëve.

Brenda muajit Maj 2015

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kemi rekomanduar Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

C. a: “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës ” për punonësit:**1. Znj. E.H, me detyrë Drejtore e Financës, në Komunën Çërravë, në cilësinë e nënpunësit zbatues, dhe anëtare e KVO-së, pasi:**

Ka kryer likuidimin e pagesave, mbi bazën e një dokumentacioni të pa rregullt i cili nuk përshkruan me vërtetësi dhe besueshmëri shkakun e veprimit, veprime këto në kundërshtim me pikën 34, 35 dhe 36 të UKM nr. 30 datë 27.12.2011.

Edhe në cilësinë e Kryetares së komisionit për blerjen me vlera të vogla, ka kryer likuidimin e pagesave dhe vendosur për tu vlerësuar si oferta më e mirë, për shërbime të ofruara nga subjekte fizike të përzgjedhur, në procedurën e prokurimit “Blerje me Vlera të Vogla”. Ndër kohë kur dokumentacioni shoqëruar, nuk është i shoqëruar me dokumentacionin për ushtrimin e këtij aktiviteti, veprim ky në kundërshtim me nenin 29, pika 5 të Ligjit nr.9643,

datë 20.11.2006, si dhe me Kreun X, pika 3, për **“Masat disiplinore”** të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tendera rezultoi se në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues, si:

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje dru zjarri”**, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik, që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi:

- Në plotësimin e kërkesës për vërtetimin e punëve të ngjashme të realizuara, pasi dokumenti i lëshuar nga Komuna Çërravë nuk shprehte asnjë shifër për sasinë e furnizuar dhe as vlerën e realizuar, kur duhej të paraqiste kontrata dhe dokumentacion financiar.

- Operatorit ekonomik i mungonte licënsa profesionale për objektin e tenderit dhe as licënsë për shfrytëzim pylli.

- Nuk është plotësuar kërkesa që operatori ekonomik të vërtetojë që nuk është debitor dhe se ka shlyer detyrimet për energjinë elektrike.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Sistemim i qendrës së fshatit Çërravë”**, nga auditimi rezultoi se në formatin elektronik të dokumenteve kualifikuese të operatorit ekonomik Shoqëria “K...”sh.p.k. se mungon:

- Deklarata e ofertuesit që të vërtetojë që nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1, të LPP, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

- Dokumenti që ofertuesi të vërtetojë disponimin e një nyje të prodhimit të betonit dhe të licënsës përkatëse për prodhim betoni, inerte dhe kontrata e blerjes, qirasë, apo zhdoganimi i impiantit të betonit.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, i cili duhej të përshkruante ecurinë e procesit të prokurimit publik të zhvilluar, kërkesa këto të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”.

2. Z. I.E, Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve, në cilësinë e kryetarit të KVO-së dhe personit përgjegjës për zbatimin e kontratave dhe kryerjen e shërbimeve e blerjeve, për:

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tendera rezultoi se në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues, si:

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje dru zjarri”**, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik, që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi:

- Në plotësimin e kërkesës për vërtetimin e punëve të ngjashme të realizuara, pasi dokumenti i lëshuar nga Komuna Çërravë nuk shprehte asnjë shifër për sasinë e furnizuar dhe as vlerën e realizuar, kur duhej të paraqiste kontrata dhe dokumentacion financiar.

- Operatorit ekonomik i mungonte licënsa profesionale për objektin e tenderit dhe as licënsë për shfrytëzim pylli.

- Nuk është plotësuar kërkesa që operatori ekonomik të vërtetojë që nuk është debitor dhe se ka shlyer detyrimet për energjinë elektrike.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Sistemim i qendrës së fshatit Çërravë”**, nga auditimi rezultoi se në formatin elektronik të dokumenteve kualifikuese të operatorit ekonomik Shoqëria “Kthella”sh.p.k. se mungon:

- Deklarata e ofertuesit që të vërtetojë që nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1, të LPP, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

- Dokumenti që ofertuesi të vërtetojë disponimin e një nyje të prodhimit të betonit dhe të licënsës përkatëse për prodhim betoni, inerte dhe kontrata e blerjes, qirasë, apo zhdoganimi i impiantit të betonit.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe nuk është hartuar Raporti Përmbledhës, i cili duhej të përshkruante ecurinë e procesit të prokurimit publik të zhvilluar, kërkesa këto të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”.

C.b: “Vërejtje për largim nga puna ” për punonësit:

1. Z. N.H, me detyrë, Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave për periudhën e vitit 2014.

Për mos plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm dhe mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit Tatimor, në kundërshtim me nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumenteve, rezulton se në Komunën Çërravë, nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), 37 subjekte, që kryejnë aktivitete të ndryshme biznesi, të cilët ushtrojnë aktivitetin pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksë biznesi të vogël dhe tarifat vendore, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë për vlerën 122,610 lekë.

Për vitin 2014 rezultojnë debitore 1,029 familje për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 1,027 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 1,028 familje në vlerën 477 mijë lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 662 familje, për vlerën 331 mijë lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 1,095 familje në vlerën 657 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e Zyrës së Tatim Taksave të Komunës Çërravë nuk është arkëtuar vlera prej 1,222,557 lekë, që i përket tarifave vendore dhe taksës së biznesit të vogël për vitin 2013 në shumën 393,651 mijë lekë, vlerës së tarifave vendore dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2014 në shumën 580,186 lekë dhe detyrimeve për taksat e tarifat vendore të biznesit të madh për të dy vitet në shumën 248,720 lekë, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Z. E.Sh, specialist i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

3. Znj. B.C, arkëtare, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

Në dosjet e tenderit nuk ka asnjë dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, apo sasinë e druve të zjarrit të nevojshme për institucionet shkollore dhe Komunën.

Për sa më lart mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç”

3. Z. N.Sh, specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO-së

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tendera rezultoi se në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues, si:

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje dru zjarri”**, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik, që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi:

- Në plotësimin e kërkesës për vërtetimin e punëve të ngjashme të realizuara, pasi dokumenti i lëshuar nga Komuna Çërravë nuk shprehte asnjë shifër për sasinë e furnizuar dhe as vlerën e realizuar, kur duhej të paraqiste kontrata dhe dokumentacion financiar.

- Operatorit ekonomik i mungonte licenca profesionale për objektin e tenderit dhe as licensë për shfrytëzim pylli.

- Nuk është plotësuar kërkesa që operatori ekonomik të vërtetojë që nuk është debitor dhe se ka shlyer detyrimet për energjinë elektrike.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Sistemim i qendrës së fshatit Çërravë”**, nga auditimi rezultoi se në formatin elektronik të dokumenteve kualifikuese të operatorit ekonomik Shoqëria “Kthjella”sh.p.k. se mungon:

- Deklarata e ofertuesit që të vërtetojë që nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1, të LPP, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.
- Dokumenti që ofertuesi të vërtetojë disponimin e një nyje të prodhimit të betonit dhe të liçensës përkatëse për prodhim betoni, inerte dhe kontrata e blerjes, qirasë, apo zhdoganimi i impiantit të betonit.

Nga komuna Çërravë, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Mirosh Bogdo, Selman Hysa, Vasillaq Peci dhe Nefail Xhepexhiu, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT